



Federata e Peshkatarëve Sportiv Recreativ e Kosovës
Savez Sportsko Recreativnih Ribolovaca Kosova
Kosovo Federation of Sports Recreational Fishermen

REGULLORE PËR PRANIMIN E KLUBEVE TE REJA NË Federatën e Peshkatarëve Sportiv
Recreativ të Kosovës

PRISHTINË KORRIK 2024

Në përputhje me nenin 19 të Statutit të **Federata e Peshkatarëve Sportiv Recreativ e Kosovës**, Bordi i FPSRK-së me datë PROPOZOJ këtë:

REGULLORE PËR PRANIMIN E KLUBEVE TE REJA

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1.

Me këtë Rregullore, rregullohet mënyra dhe kushtet për regjistrimin e shoqatave/ klubeve të peshkimit sportiv dhe të anëtarëve të tyre, puna e Komisionit për regjistrim, mënyra e mbajtjes së evidencës, si dhe çështje të tjera të rëndësishme për regjistrim.

Neni 2.

Me aktin e regjistrimit klubeve/shoqatave dhe anëtarët e tyre e fitojnë të drejtën për t'u paraqitur në garat e peshkimit sportiv dhe rekreativ, në stinorin garues për të cilin janë regjistruar. Kohëzgjatjen e stinorit garues e cakton Bordi ekzekutiv i FPSRK-së.

Neni 3.

Regjistrimin e klubeve/shoqatave dhe të anëtarëve të tyre e bën komisioni për regjistrim i FPSRK-së. Regjistrimi bëhet në kohën pas përfundimit të stinorit garues afat të cilin e përcakton Bordi. Përyjashtimisht, gjatë tërë vitit garues, mund të bëhet ripërtëritja e regjistrimit .

Neni 4.

Me rastin e paraqitjes së kërkesës për regjistrimin e klubeve/shoqatave dhe të anëtarëve të tyre, si dhe për vazhdimin e regjistrimit paguhet taksa e regjistrimit, e cila është e ardhur burimore e FPSRK-së. Lartësinë e taksës së regjistrimit e cakton Bordi ekzekutiv i FPSRK-së. Bordi përcakton edhe lartësinë e pagesës së regjistrimit të lojtarëve pas afatit të parë.

Neni 5.

Klubet/shoqatat mundën, që me ekipet dhe garuesit e tyre, të paraqiten vetë nëse e kanë regjistrimine rregullt për atë stinor garues, gjë që e dëshmojnë me dokumentet e vërtetuara. Për çdo lojtar të regjistruar lëshohet vërtetimi librezë e garave, në të cilën shënohet data e regjistrimit, përkatësisht ripërtëritjes së regjistrimit dhe datën kur lojtari i caktuar e fiton të drejtën për të luajtur minimumi 7 ditë pas regjistrimit në ndeshje ekipore, 3 ditë në ndeshje individuale. Vërtetimi garues nuk është i vlefshëm pa kontrollimin e mjekut.

II. REGJISTRIMI

SHOQATVE DHE KLUVEVE

Neni 6.

Kërkesën për regjistrim ose për ripërtëritjen e regjistrimit, klubi/shoqates ia parashtron Komisionit për regjistrim të FPSRK-së në dy kopje. Kërkesa për regjistrim ose për ripërtëritjen e regjistrimit duhet të përmbajë patjetër: Emrin e klubit/shoqates, vendin dhe adresën e selisë së klubit/shoqates, emrin, adresën dhe numrin e telefonit të personave përgjegjës (kryetari, sekretari) dhe personave të autorizuar për kontakte me FPSRK-së -në.

Neni 7.

Për regjistrimin e parë të klubit/shoqates është e nevojshme të bëhen:

- Kërkesa për anëtarësim me obligim të pranimit të veprimit në pajtim me statutin e FPSRK-së, me Rregulloret dhe vendimet e organeve të FPSRK-së,
- Fotokopjen e vërtetuar të regjistrimit nga Departamenti për Organaizata Joqeveritare,
- Kërkesën për regjistrimin e së paku 6 anëtarëve,
- Kopjet e letërnjoftimit ose certifikatës së lindjes së antarëve
- Dëshminë që klubi/shoqata i përmbush kushtet për t'u marrë me veprimtari peshkim sportiv dhe rekeativ tëpërcaktuar me Ligjin mbi sportin.
- Llogarinë bankare të klubit/shoqates
- Të gjitha këto edhe në formë elektronike në CD

Neni 8.

Çdo vit klubi/shoqata duhet ta vazhdojë regjistrimin. Për vazhdimin e regjistrimit të shoqates bëhet:

- Kërkesa për vazhdimin e regjistrimit,
- Kërkesa për regjistrimin e së paku 6 anëtarëve.
- Të gjitha këto edhe në formë elektronike në CD

Neni 9.

Komisioni për regjistrim është i obliguar që brenda 30 ditëve nga data e pranimit të kërkesës ta bëjë regjistrimin te marre vendim . Nëse regjistrimi nuk është bërë, Komisioni për regjistrim është i obliguar që ta informojë klubin/shoqaten në afat prej 30 ditëve nga data e pranimit të kërkesës, për arsyet e mospranimit të regjistrimit.

Neni 10.

Klubi/shoqata, përkatësisht lojtari janë të obliguar, që në afat prej 7 ditësh nga marrja e vendimit pozitiv të Komisionit për regjistrim, ta paguajnë taksën e caktuar për regjistrim (dhe për vazhdim të regjistrimit). Klubi/shoqata përkatësisht garuesi (nëse ka të bëjë me regjistrimin e mëvonshëm individual) nuk kanë të drejtë të lojës derisa të mos e paguajnë taksën . Nëse obligimi i lartpërmendur nuk është plotësuar as në afatin prej 30 ditëve, do të

konsiderohet se vendimi për regjistrimin është bërë, gjegjësisht që e tërë procedura as që ka filluar.

Neni 11.

Për të gjitha ndryshimet me rëndësi për regjistrim, të cilat janë bërë gjatë rrjedhës së stinorit garues, klubet/shoqatat janë të obliguara që ta informojnë Komisionin për regjistrim në afat prej 10 ditëve nga ndryshimi i bërë.

Neni 12.

Kur bëhet bashkimi i dy ose më shumë klubev/shoqatave e, shoqata e porsaformuar regjistrohet në pajtim me dispozitat e nenit 7 të kësaj Rregulloreje. shoqata i krijuar në këtë mënyrë (me bashkim) nuk do të mund të regjistrohet derisa shoqatat që bashkohen të mos i kenë kryer të gjitha obligimet.

Neni 13.

Në rast të ndryshimit të emrit, klubi/shoqates paraqet:

- Kërkesën për ndërrimin e emrit, duke shënuar emrin e vjetër dhe të riun,
- Vendimin e organit të klubit/shoqates, i cili është kompetent për ndërrimin e emrit,
- Fotokopjen e vërtetuar mbi regjistrimin me emër të ri në regjistrin e DOJQ-së.

Neni 14.

Klubi/shoqata, i cili për vitin rrjedhës nuk e bën regjistrimin nuk mund të paraqitet në asnjë nivel të garave që është në kompetencë të FPSRK-së.

Neni 15.

Klubi do të shlyhet nga evidenca e FPSRK-së nëse nuk e dorëzon kërkesën për vazhdimin(ripërtëritjen) e regjistrimit në afat prej dy vjetësh nga data e regjistrimit të fundit.

III. REGJISTRIMI I GARUESVE

Neni 16.

Si garues mund të regjistrohen të gjithë shtetasit e Kosovës, të cilët janë anëtarë të njërit nga klubet e peshkimit të Kosovës.

Nuk mund të regjistrohet personi i rritur, i cili nuk i ka të gjitha drejtat qytetare.

Me pajtimin e lidhjeve të tyre nacionale mund të regjistrohen edhe shtetasit e huaj anëtarë të klubeve të peshkimit të Kosovës.

Vendimin për afatet për procedurën e regjistrimit për stinorin e ardhshëm e bien Bordi ekzekutiv i FPSRK-së në fillim të çdo viti rrjedhës.

a) Regjistrimi i parë

Neni 17.

- Me kërkesën për regjistrim të parë, Komisionit për regjistrim i dorëzohet:
- Deklarata e nënshkruar për anëtarësim në klub/shoqate (te personat e mitur me bashkë nënshkrimin e prindit-kujdestarit),
- Fotografia me madhësi 3x4 cm, jo më e vjetër se 6 muaj,
- Deklarata me shkrim se deri më tani nuk ka qenë i regjistruar,
- Certifikata e lindjes apo letërnjoftimi

IV. PROCEDURA E ANKESAVE

Neni 18.

Kundër çdo vendimi të Komisionit për regjistrim mund të bëhet ankesë në shkallën e parë, në të cilën Komisioni është i obliguar të përgjigjet në afat prej 7 ditësh.

Neni 19.

Ankesa në vendimin e Komisionit për regjistrim i parashtrohet Bordit ekzekutiv të FPSRK-së, si shkallë e dytë, në afat prej 7 ditësh nga dorëzimi zyrtar i vendimit të Komisionit për regjistrim. Bordi i FPSRK-së do ta zgjidhë ankesën në afat prej 15 ditëve nga dita e dorëzimit të ankesës.

Neni 20.

Ankesat e bëra pas afatit nga neni 19, do të konsiderohen të vjetërsuara. Vendimet e Bordit për të gjitha ankesat për procedurën e regjistrimit janë përfundimtare.

V. E DREJTA PËR PARAQITJEN E EKIPIT

GARUESË

Neni 21

Garuesit fitojnë të drejtën e paraqitjes në garat ekipore 7 ditë pas kryerjes së regjistrimit të rregullt kurse 3 ditë për garat individuale garuesit i regjistruar e merr librezën e garave me fotografinë personale, e cila duhet të jetë e tillë që në bazë të saj të mund të bëhet identifikimi i garuesit.

Garuesi është i obliguar që para çdo gare t'ua tregojë librezën e garave personave zyrtarë.

Neni 22.

Në librezën e garave duhet të vihet vërtetimi për vizitën e bërë mjekësore.

Vërtetimi nuk guxon të jetë më i vjetër se sa që është paraparë me Ligjin për sport dhe atë mund ta lëshojnë vetëm organizatat e autorizuara mjekësore. *

VI. KOMISIONI PËR REGJISTRIM

Neni 23.

Bordi i FPSRK-së e emëron Komisionin për regjistrim. Komisioni për regjistrim përbëhet nga tre (3) anëtarë dhe punon në mbledhje, në të cilat mbahet procesverballi. Mandati i komisionit zgjat aq sa zgjat mandati i Bordit, i cili e ka emëruar.

Neni 39 .

Komisioni për regjistrim:

- Bën regjistrimin e klubeve dhe të anëtarëve të tyre dhe për këtë lëshon dokumentacionin gjegjës sipas kësaj Rregulloreje:
- I zgjedh ankesat e shkallës së parë,
- E udhëheqë evidencimin e klubeve dhe lojtarëve,
- E jep pëlqimin për kalimin e klubit në klubet e tjera

Neni 24 .

Dokumentet e regjistrimit udhëhiqen nga parime publike, të hapura, të sakta dhe të vërteta.

Çdo klub/shoqate dhe lojtar duhet ta ketë kartonin e tij, në të cilin shënohen të gjitha të dhënat relevante për regjistrimin dhe paraqitjen e garuesit.

Përveç kopjes fizike, mbahet edhe databaza elektronike me të gjitha shënimet e skanuara dhe elektronike të lojtarëve dhe klubeve/shoqatave

VII. DISPOZITA

PËRMBYLLËSE

Kjo Rregullore hyn në fuqi, shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Kryetari i Federatës së Peshkatarëve Sportiv Recreativ të Kosovës dhe publikimit në faqen zyrtare të FPSRK-së

Milaim Viti

.....
Kryetar i Federatës së Peshkatarëve Sportiv Recreativ të Kosovës

